

UDHËZUES I SHKURTËR

# SHNDËRRIMI I SHKOLLAVE NË MJEDISE MIQËSORE DHE JO ABUZUESE PËR FËMIJËT

TETOR 2020



Zbatuar nga:



UDHËZUES I SHKURTËR

# SHNDËRRIMI I SHKOLLAVE NË MJEDISE MIQËSORE DHE JO ABUZUESE PËR FËMIJËT

TETOR 2020

“Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e “Qendra për Arsim e Kosoves (KEC)” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”

“

Nëse fëmijët ndihen të sigurt, ata mund të jenë më të guximshëm, të bëjnë pyetje, të bëjnë gabime, të mësojnë të besojnë, të ndajnë ndjenjat e tyre dhe të rriten”

**ALFIE KOHN**



# 1. HYRJE

Arsimi ka për qëllim që të ju ndihmojë fëmijëve që t'i zhvillojnë shkathtësitë, dijet, sjelljet pozitive dhe të zhvillojnë potencialin maksimal të tyre, që do të iu sigurojë një të ardhme të ndritur. Është vërtetuar botërisht që për t'u arritur kjo, shkolla duhet të jetë një mjedis i sigurt, atraktiv dhe stimulues për fëmijët.

E drejta për arsim cilësor dhe mbrojtja e fëmijës është detyrim dhe përgjegjësi shtetërore. Në nivel të shtetit, e drejta për arsim garantohet nga të gjitha aktet ligjore, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës<sup>1</sup>, ku në Nenin 47, pika 1, thuhet “*Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike*”. Si vazhdimësi e kësaj, në Nenin 3 të Ligjit për Arsimin para universitar<sup>2</sup> në Republikën e Kosovës thuhet: “*Asnjë personi nuk guxon t'i mohohet e drejta për arsimim*”.

Po ashtu, në pikën 1 të nenit 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet “*Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre*”<sup>3</sup>. Nga korriku i vitit 2020, mbrojtja e fëmijës rregullohet edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës<sup>4</sup>.

Pra, duke u nisur nga fakti që e drejta për arsim dhe mbrojtja e fëmijës janë obligim dhe përgjegjësi e shtetit, ky udhëzues ka për qëllim që të përkrah shkollat me këshilla dhe udhëzime konkrete që burojnë nga detyrimet dhe përgjegjësitë institucionale për të krijuar një ambient të sigurt, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që siguron mirëqenie për fëmijët.

1 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

2 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

3 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

4 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Udhëzuesi është hartuar duke u bazuar në Rregulloren QRK nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalim dhe Referim të Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-universitar dhe Udhëzuesin për zbatimin e kësaj rregulloreje. Këto dokumente përcaktojnë detyrimet, rolet dhe procedurat e institucioneve për parandalimin, identifikimin, trajtimin, raportimin dhe referimin e dhunës në Institucionet e Arsimit Para-universitar.

Gjithashtu, ky udhëzues do t'i ndihmojë Ekipet për parandalim dhe referim të abuzimeve në shkolla, që janë themeluar nga Komunitat dhe shkollat, për të planifikuar dhe ndërmarrë masa dhe aktivitete konkrete që do të kontribuojnë në krijimin e ambienteve të sigurta në shkolla.

Ky udhëzues u hartua në kuadër të projektit “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës” i cili ka për qëllim që të mbrojë fëmijët e shkollave dhe të minimizojë të gjitha efektet e përvojës së abuzimit duke përmirësuar kapacitetet individuale dhe institucionale për parandalim të abuzimit dhe mbrojtje të viktimave. Udhëzuesi do të ofrojë këshilla dhe udhëzime konkrete për shkollat, që të krijojnë një ambient të sigurt, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që siguron mirëqenie për fëmijët.

Gjatë tre viteve të zbatimit të projektit “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës”, shkollat nga komunitat e përfshira në projekt (Ferizaj, Vushtrri dhe Kamenicë) do të vlerësohen nga Ekipet Komunale për parandalim dhe referim të abuzimeve, për shkallën e zbatimit të këtyre udhëzimeve, përkatësisht, përmbushjes së kriterëve për t'u shndërruar në një shkollë të sigurt, atraktive dhe jo-abuzuese për fëmijët. Secila shkollë që përmbush këto kritere, do të pajiset me një mirënjohje dhe një pllakë që do të vendoset në hyrje të shkollës, ku dëshmohet se Shkolla është një ambient i sigurt, jo-abuzues për të gjithë fëmijët.

---

“Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike”



## 2. INFORMATA PËR PROJEKTIN

**Projekti “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës”** u dedikohet fëmijëve duke dashur ti ndihmojmë ata në parandalimin dhe referimin e abuzimeve në shkollat ku mësojnë.

Objektiva e përgjithshme e projektit është: *Të sigurohet që të gjithë fëmijët të trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin dhe të drejtat e tyre duke promovuar mjedisin pa abuzim në shkollat e Kosovës.* Qëllimi i projektit është: Të mbrojnë fëmijët e shkollës nga abuzimi dhe të minimizojë efektet e përvojës së abuzimit, duke përmirësuar kapacitetet individuale dhe institucionale për parandalimin e abuzimit dhe mbështetjen e viktimave.

Ky projekt ka tri komponentë kryesore të cilat do të arrihen përmes aktiviteteve të planifikuara.

**Komponenti I: Përkrahja e autoriteteve dhe shkollave për t’u marrë me të gjitha llojet e rreziqeve që lidhen me abuzimin.**

- 1.1** Ndërtimi i kapaciteteve të autoriteteve komunale dhe shkollave të synuara për t’u marrë me rastet e abuzimit të fëmijës;
- 1.2** Mbështetja e autoriteteve komunale për të krijuar një sistem efikas për t’iu përgjigjur abuzimit në shkollat e synuara;
- 1.3** Sigurimi i çmimeve dhe mirënjohjeve për shkollat që prezantojnë një mjedis shembullor dhe pa abuzim;

**Komponenti II: Edukimi i nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të parandaluar abuzimin e fëmijëve në shkolla dhe t'i përgjigjen abuzimit në një mënyrë të përshtatshme.**

**2.1** Zhvillimi i kurseve të mësimit elektronik për parandalimin e abuzimit dhe reagimin ndaj abuzimit për nxënësit, mësuesit dhe prindërit duke i pilotuar ato në komunat e synuara;

Ofrimi i kurseve për parandalim ndaj abuzimit përmes platformës së mësimit elektronik për nxënësit, mësuesit dhe prindërit në gjithë Kosovën;

**Komponenti III: Ngritja e vetëdijes ku përmes aktiviteteve të shumta rrisim ndjeshmërinë e njerëzve ndaj problemit.**

**3.1** Organizimi i fushatave sociale për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mbi rreziqet që lidhen me abuzimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi praktikatat e mira;

**3.2** Organizimi i konferencës kombëtare për parandalimin e abuzimit si ngjarje përfundimtare e projektit.

Projekti ka fokus të fortë arsimor dhe synon që të sigurojë që të gjitha aktivitetet e zhvilluara të sigurojnë mundësi më të mira për të parandaluar abuzimin e fëmijës në shkolla.

Aktivitetet e projektit i përshtaten nevojave, perspektivave dhe sigurojnë pjesëmarrje të barabartë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e projektit.

### 3. KRIJIMI I SHKOLLAVE TË SIGURTA PËR FËMIJËT

Kur flasim për interesin më të lartë të fëmijës në sistemin arsimor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik dhe me përkrahjen e UNICEF kanë hartuar dokumentin “Standardet për shkollat mike për fëmijë”<sup>5</sup> i cili do të ndihmojë dhe lehtësojë zbatimin praktik të kërkesave të arsimit në funksion të interesimeve, nevojave dhe perspektivës së fëmijëve. Disa nga standardet që paraqiten në këtë dokument ndërlidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe ambientin shkollor, p.sh. Standardi 1, 2 dhe 3 në kuadër të dimensionit të tretë “Shëndeti, mjedisi dhe siguria”<sup>6</sup>

Andaj, ky udhëzues duhet të shihet si një vazhdimësi e përkrahjes për shkollat në mënyrë që të arrihen këto standarde të caktuara në kuadër të “Standardet për shkollat mike për fëmijët”. Gjithsesi, fokusi i udhëzuesit do të jetë në krijimin e një ambienti të sigurt, jo-abuzues, atraktiv dhe stimulues që siguron mirëqenie për fëmijët

<sup>5</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/standardet-per-shkollat-mike-per-femije.pdf>

<sup>6</sup> <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/standardet-per-shkollat-mike-per-femije.pdf>, faqe 27

**Janë tri aspekte të rëndësishme të krijimit të një mjedisi të tillë në shkollë:**

- 1 MËNYRA E ORGANIZIMIT TË HAPËSIRAVE SHKOLLORE;**
- 2 RREGULLORET DHE MEKANIZMAT E BRENDSHËM SHKOLLOR;**
- 3 KAPACITETI RAPORTUES NË NIVEL SHKOLLE;**

### 3.1. Mënyra e organizimit të hapësirave shkollore;

Organizimi i hapësirave shkollore është aspekt shumë i rëndësishëm në sigurimin e ambientit të sigurt dhe jo-abuzues për fëmijët. Pra, si është e organizuar ndërtesa, si është e organizuar brendia e klasës, ambienti i jashtëm i shkollës, ndriçimi, kamerat e sigurisë etj. Më poshtë janë disa sugjerime që kanë të bëjnë me mënyrën e organizimit të hapësirave të brendshme dhe të jashtme shkollore.

- a** Të gjitha hapësirat shkollore (klasat, korridoret, parkingjet dhe oborri i shkollës) duhet të jenë mirë të ndriçuara dhe dukshmëria është e mjaftueshme për stafin e shkollës që t'i mbikëqyrë të gjitha hapësirat me lehtësi;
- b** Sigurimi i rrethojës së shkollës dhe monitorimi i hyrje-daljeve në hapësirat shkollore;
- c** Vendosja e kamerave, me pëlqimin e komunitetit shkollor (duke u bazuar në legjislacionin në fuqi);
- d** Ndërtesa e shkollës ka numër të mjaftueshëm të tualeteve dhe të pastra përherë për dy gjinitë, si për nxënës/ nxënëse ashtu dhe për personel të shkollës;
- e** Dyert e tualeteve duhet të jenë të tilla që mund të hapen nga brenda pa çelës. Kjo parandalon mbylljen e fëmijëve në tualete;
- f** Dyert e dhomave ndihmëse kanë panele të tejudkshme, që të parandalohet hyrja e fëmijëve në hapësira të pasigurta me njëri-tjetrin apo me një të rritur që mund të shkaktojë dëm;
- g** Nuk ka perde që pengojnë shikimin e hapësirave në të cilat fëmijët marrin shërbime apo hapësira ku dikush mund t'i çojë fëmijët;

## 3.2. Rregulloret dhe mekanizmat e brendshëm shkollor

Aspekt tjetër shumë i rëndësishëm janë edhe Rregulloret dhe mekanizmat e brendshëm, të cilat adresojnë çështje që lidhen me rendin shtëpiak, rregulloret për stafin shkollor, mekanizmat e brendshëm që adresojnë çështjet e dhunës, abuzimit dhe sigurisë. Më poshtë janë disa sugjerime:

- a** Varësisht nga nevoja dhe konteksti, shkolla duhet të ketë rregullore të brendshme të cilat lehtësojnë funksionimin e shkollës në linjë me interesin më të lartë për fëmijët;
- b** Shkolla duhet të hartojë rregullat e sjelljes që ndalojnë dukuritë jo të shëndetshme dhe vazhdimisht e monitoron zbatimin e tyre;
- c** Shkolla duhet të sigurojnë zbatimin e rregullave të brendshme që përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit individ që frekuenton shkollën;
- d** Shkolla duhet të realizojë aktivitetet jashtë-kurrikulare, si: ligjërata, debate, aktivitete artistike me temë kundër dhunës dhe abuzimit;
- e** Të kenë të vendosur kutinë për të drejtat e fëmijës/kutia e ankesave dhe parash-trasave, e njëjta të hapet sipas rregullave përkatëse të institucionit;
- f** Të identifikojnë fëmijët në rrezik potencial për të shfaqur sjellje të dhunshme dhe ata të neglizhuar nga familja dhe të sigurojnë bashkëpunimin me institucionet relevante për të siguruar përkrahjen e tyre;
- g** Shkolla ka strategji se si t'i inkurajojë dhe t'u mundësojë mësimdhënësve të fitojnë njohuri dhe zhvillojnë shkathtësi të reja për parandalimin e ngacmimeve dhe abuzimit (pjesëmarrje në trajnime, konferenca, seminare etj.);

- h Shkolla duhet të krijojë mekanizma për zgjidhjen e pa dhunshme të konflikteve si dhe për të kontribuar në krijimin e ambienteve miqësore (Ekipi për parandalim të dhunës/abuzimit, Grupi i Ndërmjetësimit me bashkëmoshatarëve);
- i Shkolla duhet të hartojë kalendarin vjetor të aktiviteteve shkollore jashtë-kurrikulare, ku përfshihet edhe aktivitetet vetëdijësuese për parandalimin dhe referimin e dhunës dhe abuzimit;
- j Shkollat që kanë psikolog/pedagog, sigurojnë përkrahje të vazhdueshme për nxënësit nga grupet e cenueshme. Në rastin kur shkolla nuk ka psikolog/pedagog, duhet të bashkëpunojë ngushtë me akterët tjerë relevant që do të siguronin përkrahje për këtë kategori të fëmijëve.

---

Të identifikojnë fëmijët në rrezik potencial për të shfaqur sjellje të dhunshme dhe ata të neglizhuar nga familja dhe të sigurojnë bashkëpunimin me institucionet relevante për të siguruar përkrahjen e tyre

### 3.3. Kapaciteti raportues në nivel shkollë

Shkolla duke u bazuar në rregulloret e brendshme dhe në obligimet ligjore, (shih 3.2. Rregulloret dhe mekanizmat e brendshëm shkollor) duhet të krijoj kapacitete për trajtimin, raportimin dhe referimin e dhunës dhe çfarëdolloj abuzimi që mund të ndodh, ku cak janë fëmijët. Më poshtë janë disa sugjerime:

- a** Çdo nxënës, mësimdhënës, udhëheqës, prind dhe punonjës tjetër në institucion arsimor që dyshon ose ka dëshmi të bazuar se një fëmijë vuan ose është viktimë e ndonjë forme të dhunës ose që dyshon ose ka dëshmi të bazuar se një fëmijë vuan nga abuzimi fizik, seksual ose psikologjik, obligohen që menjëherë ta raportojnë rastin;
- b** Të gjitha rastet e dhunës të paraqitura në shkollë duhet të shqyrtohen menjëherë nga drejtori i institucionit të arsimit para universitar, duke pasur parasysh çdo herë interesin më të lartë të fëmijës;
- c** Drejtori i institucionit të arsimit para universitar është obliguar të sigurojë, ruajë dhe të analizojë të dhënat mbi dhunën e paraqitur në institucionin që drejton, në mënyrën më të mirë të mundshme;
- d** Regjistri i rasteve të dhunës në institucionet e arsimit para-universitar mbahet sipas udhëzimeve nga Sistemi i Menaxhimit të informatave në Arsim, duke iu referuar Udhëzuesit për zbatim të Protokollit për Parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para universitar (Rregullore QRK-21/2013);
- e** Institucioni i arsimit para-universitar duhet të referojë rastin në Polici pa deklaram paraprak të palëve në rastet kur ekziston dyshim i arsyeshëm se fëmija është viktimë apo dëshmitar i veprës penale, kur është në interesin më të lartë të fëmijës dhe kur intensiteti i dhunës dhe nevoja për ndërhyrjen e Policisë së Kosovës është e domosdoshme;

- f** Institucioni i arsimit para-universitar duhet të referojë rastin e dhunës apo abuzimit në Qendër për Punë Sociale kur vinë në dijeni se fëmija ka nevojë për mbrojtje dhe trajtim nga shërbimet profesionale sipas mandatit të përcaktuar me ligj;
- g** Institucioni i arsimit para-universitar duhet të referojë rastin e dhunës apo abuzimit në Qendër të Mjekësisë Familjare kur vijnë në dijeni se fëmija ka nevojë për trajtim nga shërbimet shëndetësore sipas mandatit të përcaktuar me ligj;
- h** Drejtori i institucionit të arsimit para universitar bazuar në regjistrin e rasteve raporton në Drejtorinë Komunale të Arsimit
- i** Këshilli Drejtuesi institucionit të arsimit para-universitar në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Nxënësve dhe Këshillin e Prindërve analizon të të dhënat mbi dhunën e paraqitur në kuadër të institucionit ku vepron, dhe rekomandon marrjen e masave dhe veprimeve të mëtejme.

---

Çdo nxënës, mësimdhënës, udhëheqës, prind dhe punonjës tjetër në institucion arsimor që dyshon ose ka dëshmi të bazuar se një fëmijë vuan ose është viktimë e ndonjë forme të dhunës ose që dyshon ose ka dëshmi të bazuar se një fëmijë vuan nga abuzimi fizik, seksual ose psikologjik, obligohen që menjëherë ta raportojnë rastin



## 4. SHKOLLA SI MJEDIS MIQËSOR PËR FËMIJËT

Shkolla duhet të jetë një mjedis miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues për të gjithë nxënësit. Zbatimi i udhëzimeve dhe sugjerimeve të ofruara në kuadër të këtij udhëzuesi të shkurtër, do të ndihmojnë shkollat për t'i shndërruar në mjedise miqësore për fëmijët.

Mjedisi miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues nënkupton krijimin e klimës pozitive në shkollë që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin fizik, social, emocional për të gjithë fëmijët. Për më tepër klima pozitive shkollore mund të çojë në ulje të mungesave, të shërbejë si një metodë e parandalimit të dukurive negative dhe të zvogëlojë efektet e pabarazive socio-ekonomike. Shkollat mjedis të tillë, minimizojnë rastet e dhunës, ka më pak ngacmim dhe arrijnë rezultate më të mëdha akademike.

Sipas Rregullores QRK 21/2013, institucionet të cilat merren me parandalimin dhe reagimin ndaj veprimeve të dhunshme në institucionet e arsimit para-universitar, klasifikohen në nivelet si vijon: **Rrjeti i brendshëm mbrojtës:** Edukimi parashkollor – (Drejtori i Institucionit, Këshilli i Prindërve) dhe Shkollat (Drejtori i shkollës, Këshilli i Prindërve, Këshilli Drejtues i Shkollës dhe Këshilli i Nxënësve); **Rrjeti i jashtëm mbrojtës:** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - MASHT- (Sektorët e Inspektimit të Arsimit në Rajon), Këshilli i Prindërve të Kosovës, Këshilli i Nxënësve në nivel nacional), Drejtoria Komunale e Arsimit - DKA - (Këshilli i Nxënësve dhe Këshilli i Prindërve në nivel komunal, Zyrtari përkatës për të Drejtat e Fëmijëve), Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - (Qendra për Punë Sociale - QPS), Qendrat e Mjekësisë - QMF, Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Sprovues i Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Policia e Kosovës si dhe Mekanizmat tjerë ndihmës - Mediat, Institucioni i Avokatit të Popullit, organizatat joqeveritare që punojnë për të drejtat e fëmijëve dhe çështjet e dhunës në shkollë.

Pra, në mënyrë që shkollat të jenë mjedise miqësore, të sigurta, të pa-dhunshme, jo abuzive dhe jo diskriminuese për të gjithë nxënësit, nevojitet një mobilizim i gjithë atyre që janë pjesë e rrjetit të brendshëm dhe atij të jashtëm mbrojtës. .

---

Shkolla duhet të jetë një mjedis miqësor, i sigurt, i pa-dhunshëm dhe jo diskriminues për të gjithë nxënësit. Zbatimi i udhëzimeve dhe sugjerimeve të ofruara në kuadër të këtij udhëzuesi të shkurtër, do të ndihmojnë shkollat për t'i shndërruar në mjedise miqësore për fëmijët.



